

**VENDIM**  
**Nr. 370, datë 29.5.2019**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 730, DATË 20.10.2016, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET, KRITERET,**  
**TARIFAT, AFATET DHE PROCEDURËN PËR KLASIFIKIMIN E STRUKTURAVE**  
**AKOMODUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 45, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në tekstin e rregullores të miratuar me vendimin nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat si vijon:

1. Në nenin 1 pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:  
“4. Kategorizimin e strukturave akomoduese.”.
2. Në nenin 3 pas shkronjës “c” shtohet c/1, me këtë përmbajtje:  
“c/1. Certifikatë kategorizimi, dokumenti i lëshuar nga komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike për llojin e strukturës akomoduese.”.
3. Në nenin 4, pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:  
“3 Çdo sipërmarrës turistik që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese duhet të pajiset me certifikatë kategorizimi.
4. Mënyra dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese përcaktohen me urdhër ministri.”.
4. Pas nenit 7 shtohet neni 7/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Për strukturat akomoduese me 4 apo 5 yje që janë mbajtëse të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “*Brand name*”, vlerësimi për klasifikimin e tyre bëhet nga ministria përgjegjëse për turizmin, me kërkesë të vetë sipërmarrësit turistik, deri në nënshkrimin e marrëveshjes me agjenci apo organizata ndërkombëtare, të mirënjohura në fushën e vlerësimit të strukturave akomoduese, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të nenit 7, të rregullores.”.

5. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**